



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

---

Tiranë, më 09.02.2023

**Informacion mbi zhvillimin e Analizës Vjetore të Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit**

Më datën 09.02.2023, në ambjentet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, u zhvillua Analiza Vjetore mbi aktivitetin e Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit për vitin 2022, në zbatim të Urdhrit Nr. 11 datë 24.01.2023 të Kryetarit të KLSH-së. z. Arben Shehu. Në këtë aktivitet morën pjesë Drejtoresha e Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit znj. Yllka Pulashi, si dhe auditues të këtij departamenti.

Analiza u çel nga Drejtoresha e departamentit e cila referoi një raport mbi aktivitetin e Departamentit të Auditimit IT për vitin 2022. Znj. Pulashi theksoi se KLSH e zhvillon auditimin e teknologjisë së informacionit (TI) prej 8 vitesh tashmë, me objektiv kryesor ekzaminimin e zbatimit të sistemeve TI-së të subjekteve për të siguruar që ato përmbushin nevojat e subjektit të audituar, pa kompromentuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të veprimitarisë së tij. Gjatë vitit 2022 është vazhduar me përfshirjen në projektet e auditimit të subjekteve që kanë lidhje me çështjen e audituar duke bërë që për çdo auditim të kryer të mbulohen mesatarisht 2 subjekte duke ruajtur trendin e tre viteve të fundit për këtë tregues.



Në auditimet e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, nga auditimet e kryera përgjatë vitit 2022, u shfaqën mangësi në subjektet si AKU, APP, ASHK, Universitetin e Tiranës, Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali, Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe UK Durrës SHA, konkretisht në:

- Fushën e funksionimit të Qeverisjes TIK;
- Fushën e Sigurisë së Informacionit;
- Fushën e zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit;
- Fushën e Auditimit të Sistemeve.

Në fjalën e saj, znj. Pulashi nënvizoi se përgjatë vitit 2022, për përmirësimin e gjendjes janë dhënë 148 rekomandime të llojit “Masa organizative”, 2 “Masa për shpërblimin e dëmeve” të shkaktuara buxhetit të shtetit, 1 “Masë disiplinore”, 3 “Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike” dhe 1 “Masë administrative”, si dhe është arritur në 7 konkluzione të përgjithshme mbi auditimet.

Gjithashtu, u prezantuan objektivat kryesor të Departamentit për vitin 2023, duke mbajtur në fokus; Rritjen e impaktit të punës audituese ; Auditimi mbi bazë risku – qasje efektive e auditimit ; Konsolidimi i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit; rritja e kapaciteteve audituese dhe profesionale; realizimi i punës audituese me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara; forcimi i marrëdhëniet me koleget duke rritur përpjekjet dhe gatishmërinë për të punuar dhe bashkëvepruar në grup etj.

Në vijim të Analizës, mbajtën prezantimet e tyre z. Benard Haka mbi Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), znj. Anxhela Kostaj mbi Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU), si dhe z. Rodjan Alimerkaj mbi Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Universitetet e Tiranës, Vlorës “Ismail Qemali” dhe Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Ky aktivitet u shoqërua edhe me diskutime të frytshme midis audituesve të departamentit të cilat patën si synim shkëmbimin e eksperiencave të fituara në auditimet përkatëse vitin e shkuar, evidentimin e sfidave dhe gjetjeve të përbashkëta nëpër auditime, si dhe identifikimin e disa fushave me risk ku audituesit do të mund të fokusohen gjatë auditimeve aktuale që po zhvillohen.